



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "LURN" Sh.P.K. të datës 21.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i objekteve komunale dhe bashkësive lokale" me nr. të prokurimit 616-26-2203-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "LURN" Sh.P.K. të datës 21.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i objekteve komunale dhe bashkësive lokale" me nr. të prokurimit 616-26-2203-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "LURN" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 21.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i objekteve komunale dhe bashkësive lokale" me nr. të prokurimit 616-26-2203-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:** "1. **Pika d)** Kërkesa për Inxhinier të Arkitekturës me minimum 8 vite përvojë dhe trajnim specifik për menaxhim dhe siguri në kantiere është joproporcionale. Duke u bazuar në Paramasë dhe Paralogari, nuk evidentohet kompleksiteti i tillë që justifikon një përvojë kaq të lartë. Kjo kërkesë kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë pa arsye objektive. 2. **Pika g)** Kërkesa për Inxhinier të Hidroteknikës me trajnim në sisteme të ngrohjes dhe ftohjes është profesionale e papërshtatshme. Ka mospërputhje ndërmjet profilit (hidroteknik) dhe kërkesës për HVAC. Paramasa nuk rezulton nevoja për një profil të tillë të kombinuar. 3. **Pika i)** Teknik i Elektroteknikës me minimum 10 vite përvojë dhe certifikime të ndihmes se pare:k. Kombinimi i përvojës së lartë me certifikime kufizon konkurrencën në mënyrë të panevojshme. 4. **Pika j)** Mjeshtër i drenazimit me trajnim për menaxhim dhe monitorim: Paramasa nuk parashih punime të një niveli që kërkon ekspertizë kaq të specializuar. Kërkesa është e paarsyetuar dhe diskriminuese. kërkojme që të hiqet si kriter sepse është i panevojshëm duke u bazuar në natyrën e punimeve".

**Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit,** është gjetur se kërkesat për stafin profesional konkretisht për arkitektin, inxhinierin hidroteknik, teknikun elektroteknik dhe mjeshterin e drenazhit janë absolutisht të domosdoshëm për të garantuar realizimin e projektit në mënyrë efikase dhe efektive. Duhet sqaruar se kërkesat e DT janë vendosur në përputhje të plotë me qëllimin dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit. Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 24.04.2026**

**Visar SHEHU**  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.